

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm me gjyqtaren Saranda Bogaj-Sheremeti, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit, H. T. nga K., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokat N. K. nga P., kundër të paditurës Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës- “ Infrakos” sha, të cilën e përfaqëson G. H., me bazë juridike anulim i aktvendimit për largim nga puna, në seancën e shqyrtimit kryesor me datë 12.09.2014, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit H. T. nga K., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës- “ Infrakos” sha, të anulohet aktvendimi nr *numri...* i datës 29.02.2011 me të cilin është ndërprerë marrëdhënia e punës si dhe vendimi i shkallës së dytë mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe largim nga Hekurudhat e Kosovës nr.../. i datës 14.09.2011, duke detyruar të paditurën që paditësin ta kthejë në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës si dhe t’ia kompenzojë dëmin në emër të pagave në vlerë prej 340 euro për çdo muaj duke filluar prej 26.01.2011 me kamatë ligjore duke përfshirë edhe shpenzimet e procedurës, SIE PABAZUAR.
- II. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë.

A r s y e t i m

Paditësi si në padi ashtu edhe gjatë shqyrtimit kryesor ka kërkuar që të detyrohet e paditura Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës- “ Infrakos” sha, të anulohet aktvendimi me të cilin është ndërprerë marrëdhënia e punës nr *numri...* i datës 29.02.2011 si dhe vendimi i shkallës së dytë mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe largim nga Hekurudhat e Kosovës nr.../. i datës 14.09.2011 duke detyruar të paditurën që paditësin ta kthejë në punë me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës si dhe t’ia kompenzojë dëmin në emër të pagave në vlerë prej 340 euro për çdo muaj duke filluar prej 26.01.2011 me kamatë ligjore duke konsideruar se me Rregulloren e Marrëdhënies së Punës në Hekurudhat e Kosovës nr. 245 të datës 12.03.201 është paraparë afati i parashkrimit të procedurës disiplinore ku neni 83 parasheh se procedura disiplinore parashkruhet me kalimin e afatit të 6 muajve nga dita kur është bërë shkelja. Sipas vendimit të kontestuar

dhe regjistrit të biletave pretendohet se i padituri ka bërë falsifikimin e biletave të cilat janë dhënë në vitin 2010, kurse komisioni disiplinor ka vendosur me datë 26.08.2010 pas kalimit të afatit të parashkrimit .Me aktvendimin e kontestuar nuk është vërtetuar se paditësi ka kryer shkeljet e parapara, pastaj me aktvendimin e kontestuar askund nuk është arsyetuar mënyra e kryerjes së shkeljes së obligimeve të punës e as që janë dhënë provat në bazë të cilave është konstatuar përgjegjësia. Si dëshmi përmendet raporti i komisionit për kontrollin e biletave kurse ky komision në krye të shkresës së vet thekson se biletat janë të dyshuara për falsifikim pra nuk thekson se janë të falsifikuara.

Nga kjo rezulton fakti se vendimi i Komisionit Disiplinor i të paditurës me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe është larguar nga Hekurudhat e Kosovës është i kundërligjshëm.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura me përgjigje në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë, si të pa bazuar. Paditësi në procesverbalin e dëgjimit të punëtorit me datë 29.07.2011 në ora 09.30, para komisionit disiplinor në deklaratën e vet ka pranuar se e ndien veten fajtor e pranon gabimin e bërë në biletat e falsifikuara , me cka vërtetohet se paditësi ka bërë shkelje të detyrave dhe obligimeve të punës sipas neneve të cituara në aktvendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës andaj njëherit i kontestoj në tërësi si të pabazuar pohimet e përfaqësuesit të paditësit dhe i propozoj gjykatës që kërkespadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 01.09.2014, sipas propozimit të palëve ka administruar provat relevante dhe atë: vendimi nr. *numri i vendimdt...* i datës 29.08.2011, vendimi nr *../..* i datës 14.09.2011, vendimi nr *numri i vendimit...* i datës 29.07.2011, regjistri i biletave *..-* i stacionit hekurudhor ne Pejë periudha e kontrollimit 01.01.2012 deri më 21.12.2012, deklarata e punëtorit e datës 29.07.2011, biletat *..-*të falsifikuara gjatë muajit qershor 2011 për muajin gusht 2010, muajin korrik 2010, biletat *..-* nr *numri...*, nr *numri...*, *numri...*, *numri...* , *numri...*, *numri...* dhe *numri...* si dhe biletat e falsifikuara nga *..-* sipas regjistrit, rregullorja nr.245 e datës 12.03.2010 dhe kontrata e punës 01.07.2010.

Pasi që Gjkata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye :

Në bazë të provave të administruar gjykata gjeti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune te e paditura, mirëpo në bazë të vendimit nr.*numri i vendimit...* i datës 29.08.2011 paditësit i ndërprehet marrëdhënia e punës dhe largohet nga Hekurudhat e Kosovës për shkak të shkeljeve të rënda të obligimeve të punës nga neni 65 pika 1, nenit 70 pika 4 dhe

18, si dhe nenit 71 pika 2,4,10 dhe 30 të Rregullores mbi Marrëdhënien e Punës në Hekurudhat e Kosovës.

Gjykata gjeti se me vendimin nr *numri i vendimit...* i datës 29.07.2011 e paditura ka formuar Komisionin për kontrollimin dhe verifikimin e biletave .-. të lëshuara në stacionin hekurudhor në Pejë për vitin 2010, komisioni i përbërë prej tre anëtarëve kanë bërë regjistrimin dhe evidentimin e biletave .-. të Stacionit Hekurudhor në Pejë për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2012 ku duke u bazuar edhe në deklaratën e dhënë nga paditësi para këtij Komisioni është vërtetuar se ka pas parregullsi dhe falsifikim të biletave.

E paditura me datën 14.09.2011 merr vendimin me të cilin me të cilin i ndërprehet marrëdhënia e punës dhe largohet nga Hekurudhat e Kosovës duke vendosur në bazë të ankesës së paditësit kundër vendimit të Komisionit Disiplinor nr. *numri i vendimit...* I datës 29.08.2011.

Gjykata pasi që i administroi të gjitha provat lidhur me këtë çështje kontestuese nga marrëdhënia e punës gjeti se paditësi ka keqpërdorur pozitën e tij duke bërë falsifikim të dokumentacionit rrethanë e cila është vërtetuar edhe nga biletat e falsifikuara për muajt qershor 2011 ,korrik 2010 dhe gusht të vitit 2010 të cilat janë dhënë nga paditësi si drejtuesi i trenave.

Gjykata vërtetoi se ka pasur shkelje të detyrave të punës edhe në deklaratën e paditësit para Komisionit Disiplinor ku paditësi deklaroi se e pranon gabimin për biletat e falsifikuara nga muaji qershor ndërsa për falsifikimet e mëparshme nuk di asgjë.

Ndërsa sa i përket pretendimit të autorizuarit të paditësit se Komisioni Disiplinor ka vendosur pas skadimit të afatit të parashkrimit ngase kanë kaluar gjashtë muaj nga shkelja duke u bazuar në nenin 83 të Rregullores së Marrëdhënies së Punës në Hekurudhat e Kosovës nr.245 e datës 12.03.2010, gjykata gjeti se në po të njëjtin nen të kësaj rregulloreje por në par 2 të nenit 83 thuhet se nëse shkelja e detyrave dhe obligimeve të punës përmban elemente të veprës penale, procedura disiplinore parshkruhet me kalimin e kohës prej 1 viti, prej ditës kur është bërë shkelja e detyrave dhe obligimeve të punës.

Gjykata vendimin e saj e mbështeti duke u bazuar në nenin 85 par 3 te Ligjit te Punes në të cilin thuhet se shqiptimi i masës disiplinore ndërpreje e marrëdhënies së punës do të shqiptohet për shkak të shkeljeve të rënda të detyrave të punës në pajtim me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit, dhe Kontratën e Punës e që në rastin konkret paditësi ka shkelur Rregullorën e Marrëdhënies së Punë si akt i brendshëm i punëdhënësit duke vepruar në kundërshtim me me nenin 65.2 nenin 70.4 dhe 18 nenin 71 pika 2,4, 10 dhe 30 të po kësaj rregulloreje.

Vendimi që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta, gjykata e mbështet në dispozitën e nenit 450 dhe 452.2 të LPK-ës.

Mbi bazën e të dhënave si më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm
C.nr. 2145/11, I datës 12.09.2014

Gjyqtarja :

Saranda Bogaj-Sheremeti

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.